

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zjarri në Koçan, dëshmia e inspektores: Pronari i “Pulsit” nuk paraqiti licencën dhe hyrja ishte e pakalueshme
ADRESA	https://albeu.com/maqedoni/zjarri-ne-kocan-deshmia-e-inspektores-pronari-i-pulsit-nuk-pa-raqiti-licencen-dhe-hyrja-ishte-e-pakalueshme/1016475/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 18:02:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 18:00:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	11fd857a659f8e80175c5a5b7617ae6f02b211dda61a4d0d5a3006c0b8e48964
TEKSTI	5aa45cebe5999a7b422a51d46e6f672cf33bc44bf5130ca15e180a631097ab68
PAMJA	df6fa6aa19834e63e83767575cdb05fd2844abf1557f35f641a4e27243e0dbc6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0ef31ef6bfa743bc77289aa8ecfca24891e0b3ade7e71705347a2b812d24045f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	902d0413a229cd6f0d4d0cd18f47f680be9b1c51dede64b7e44b0e89ca82109d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0ef31ef6bfa743bc77289aa8ecfca24891e0b3ade7e71705347a2b812d24045f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Zjarri në Koçan, dëshmia e inspektore: Pronari i “Pulsit” nuk paraqiti licencën dhe hyrja ishte e pakalueshme



Gjatë kontrollit të zhvilluar në vitin 2023, pronari i kafezës “Puls” në Koçan, Dejan Jovanov, nuk ua vuri në dispozicion për verifikim licencën e punës zyrtarëve policorë. Po ashtu, hyrja drejt objektit ishte e bllokuar plotësisht nga automjetet e parkuara. Këto detaje i bëri të ditura në gjykatë Despina Simeonova, inspektore e pavarur në Qendrën Rajonale për Çështje Kufitare Lindje – Dellçevë, e cila dëshmoi në procesin ndaj nëntë policëve të akuzuar për zjarrin në diskotekën Pulse.

Simeonova u mor në pyetje drejtpërdrejt nga Prokuroria. Ajo deklaroi se në Ministrinë e Punëve të Brendshme punon që nga viti 2001 dhe se gjatë viteve 2022 dhe 2023 ka ushtruar vazhdimisht detyrën e inspektore për të huaj, si në punët administrative, ashtu edhe në aktivitetet në terren.

Duke folur për mënyrën e organizimit të kontrolleve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, inspektoria shpjegoi se veprimet e bazuara në Ligjin për të Huajt kryhen vetëm nga inspektorët për të huaj. Ndërsa aksionet e përfshira në planet operative zhvillohen bashkë me inspektorë dhe zyrtarë të institucioneve të tjera.

“Kur punojmë në pjesën tonë, sipas Ligjit për të Huajt, puna mund të jetë individuale dhe në atë rast veprojmë vetëm ne, inspektorët për të huaj. Kur punojmë sipas planeve operative, planeve shtesë të MPB-së – Byrosë për Siguri Publike, kjo do të thotë se kemi aksione të përbashkëta me inspektoratet e tjera, me kolegë nga MPB-ja, me Inspektoratin e Tregut, Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe me inspektorë të tjerë të nevojshëm që përfshihen në atë plan operativ, varësisht nga nevojat”, tha Simeonova.

Sipas saj, në Komunën e Koçanit kontrollet përqendrohen kryesisht te objektet e hotelierisë, hotelet, motelet, bujtinat dhe apartamentet që ofronin akomodim. Synimi ishte identifikimi i rasteve të qëndrimit të parregullt ose të paligjshëm të shtetasve të huaj.

të fundit /



Zjarri në Koçan, dëshmia e inspektore: Pronari i “Pulsit” nuk...



Hadergjonaj refuzon të luajë për Kosovën me Fodën: Mungojnë...



110 ditë rezistencë kundër regjimit/ Marshimi nis nga...



Negrovci pas dënimeve të Hagës: 'Ata s'mund t'i dënojnë në emrin...



Shënohet viktima e parë në Kosovë nga Virusi i Nilit Perëndim...



Klestor Veseli tregon përhëndetjen e koduar me të atin në sallën e...



Carlos Espí, 'arma sekrete' e Mourinhos: Nga Levante te heroi...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Sa i përket objektit "Puls", Simeonova konfirmoi se në vitet 2022 dhe 2023 aty ishin kryer disa kontrole, gjithnjë brenda fushës së kompetencave të saj. Për çdo kontroll përgatitej një raport, i cili më pas i dorëzohej Qendrës Rajonale për Çështje Kufitare Lindje.

Aksionet zhvilloheshin gjatë natës. Në fillim ato kryheshin nga ora 22:00 deri në 03:00, ndërsa më vonë orari ishte nga 23:00 deri në 04:00. Për evidentimin e parregullsive dhe për koordinimin e veprimeve, çdo plan operativ kishte një person të caktuar si përgjegjës.

"Ai është përgjegjës që pas përfundimit të përpilojë raport dhe ta dorëzojë te shërbimi kujdestar, përkatësisht në Stacionin Policor në Koçan. Supozoj se SP Koçan, sipas hierarkisë së të punësuarve, përgjegjësi duhet ta përcjellë atë në SPB Shtip", tha dëshmitarja.

E pyetur për gjendjen e trafikut pranë diskotekës, inspektorja tha se qarkullimi ishte i çrregullt dhe se automjetet pengonin kalimin. Ajo përmendi edhe parkingun e hotelit aty pranë, i cili ishte i mbushur.

"Kaos është, me një fjalë – nuk mund të kalohet. Parkingu që përdoret nga hoteli aty pranë është plot, ndërsa në rrugën para diskotekës nuk mund të kalohet për shkak të automjeteve të parkuara", dëshmoi Simeonova.

Inspektorja tregoi gjithashtu se si ishte kërkuar dokumentacioni i punës së objektit. Sipas saj, kolegu Zlatko Kuzmanovski, përgjegjës për planin e aksionit, kërkoi licencën në praninë e saj.

"Me kërkesë të kolegut Zlatko Kuzmanovski, i cili ishte përgjegjës për planin e aksionit, në praninë time u kërkuua licenca e punës së diskotekës 'Puls'. Nga pronari Dejan Jovanov licenca nuk na u tregua dhe as nuk na u dha për kontroll, me shpjegimin se ishte shumë vonë për ta kërkuar kontabilistin, pasi ai nuk ndodhej në ambientet e diskotekës dhe se do ta sillte të hënën. Ai pretendonte se dokumentet për rinovimin e licencës së punës i kishte dorëzuar 15 ditë më parë në Shkup dhe në atë moment pretendonte se licenca ishte e vlefshme deri më 31 mars 2023. Nga ana ime dhe e kolegut kjo u shënuar në raport atë mbrëmje", tha Simeonova në dëshminë e saj.

Seanca ndaj nëntë zyrtarëve policorë do të vijojë me marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe administrimin e provave materiale të propozuara nga Prokuroria.

Më 16 mars 2025, gjatë performancës së grupit ADN, një zjarr përfshiu diskotekën "Pulse" në Koçan. Si pasojë, 63 persona humbën jetën dhe më shumë se 200 të tjerë u plagosën. Ngjarja konsiderohet ndër tragjeditë më të rënda të historisë së re të vendit.

Në këtë proces gjyqësor janë gjithsej 35 persona dhe tri kompani të akuzuar. Në mesin e tyre janë pronari dhe persona të punësuar në diskotekë, ish-ministra të ekonomisë, ish-kryetarë të Komunës së Koçanit, inspektorë dhe zyrtarë të tjerë. Të gjithë akuzohen për të njëjtën vepër penale, "shkaktim të veprave të rënda kundër sigurisë së përgjithshme".

Shtuar më 17.09.2026 20:00

Tags: [Tragjedia në koçani](#)



Ali Ahmeti thërret Kryesinë Qendrore të BDI-së, diskutohen zhvillimet për...



Bujqit kërkojnë vaksina: Kopeve në Malin Sharr u kanoset rreziku nga lija e...



Guvernatori Slavenski: Sistemi i ri kombëtar i pagesave imiton platform...



Jotova: Bullgaria i ka përmbushur të gjitha kërkesat ndërkombëtare...



Murati pret ankesë ndaj aktgjykimit për ish-drejtuesit e UÇK-së



Andonovski pret miratimin e strategjisë për inteligjencën artificiale deri në fund të...



Dimitrieska-Koçoska: Thellojmë bashkëpunimin me CEB-in për arsim,...



Dyshohet se u godit nga rryma, humb jetën 35-vjeçari në Studeniçan



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.